

MRSA- Dekolonizimi në shtëpi

Njoftim për pacientët

Çka është një dekolonizim?

Lëkura, mukoza në hundë dhe fyti trajtohen me synim të qartë për të eliminuar *Staphylococcus aureus* rezistent ndaj metilicilines (MRSA). Për këtë përdoren një „sapun“ dezinfektues dhe ujë për shpërlarjen e gojës, si dhe një krem antibakterial i hundës.

Mjetët përkatëse do ti merrni ose nga spitali ose do t'iu lëshohet një recetë.

Përdorimi i produkteve

Kremi i hundës (2x në ditë)

- Me një shkop të veshëve ose me gishtin e vogël të vendoset një sasi e kremit të hundës sa maja e fije së qibrimit në secilën vrimë të hundës.
- Pastaj e ndrydhni hundën dhe mes gishtit të madh dhe gishtit tregues e ngjeshni. Më pas i lani duart me „sapunin“ dezinfektues.

Shpërlarja e gojës (2x në ditë)

- Para përdorimit të ujit për shpërlarjen e gojës duhet pastruar dhëmbët me pastë të dhëmbëve, më pas duhet shpërlarë gojën mirë me ujë (largimi i mbetjeve të pastës së dhëmbëve!).
- Me masen e caktuar (sipas recetës) e shpërlani/ gurgulloni për një minutë dhe e pështyni. Mos e shpërlani pastaj me ujë. Pastaj gjatë 20 minutave as mos hani e as mos pini.
 - **Proteza e dhëmbëve:** Gjatë shpërlarjes së gojës e vendosni protezën për 15 minuta në tretësin për shpërlarjen e gojës. Protezën para vendosjes e shpërlani mirë me ujë (largimi komplet i pastës së dhëmbëve). Tretësin e ndërroni përditë.

„Sapun“ dezinfektues për dush/ larje të flokëve (1x në ditë)

Përdorni gjatë dekolonizimit për larje/ dush vetëm „sapunin“ special dezinfektues. Ai përdoret i pa t'holluar në lëkuren e lagur. Mos përdorni mjete tjera të dushit, shampona dhe sapuna.

Veprimet gjatë dushit

Vendosni „sapunin“ dezinfektues direkt në lëkurën e lagur, përkatësisht në flokët e lagura ose në një leckë të pastrimit. Pastroni intensivisht pjesët e trupit sipas rradhitjes në vijim:

1. Flokët
2. Ballin – fytyrën – veshët – fytin (mos të fërkohen sytë me sapun)
3. Krahët – sqetullat – pjesa e sipërme e trupit
4. Shpinën (nëse është e mundur me ndihmë)
5. Regjioni inguinal – pjesët gjenitale – pjesët anale
6. Këmbët – shputat

Lëreni „sapunin“ dezinfektues së paku 1 min. të ndikoj

- Shpërlani pastaj tërë trupin nga lart të poshtë me ujë të rrjedhshëm.
- Terni trupin me një peshqir të pastër.
- Kujdesuni përditë për trupin tuaj me një ujë fërkues të trupit (një lëkurë e paprekur është parakusht për një dekolonizim të suksesshëm).
- Veshni rroba të pastërta (sidomos rrobat e brendshme dhe çorapët).

Masat e tjera**Larja/ teshat**

- Ndërroni teshat e shtratit nëse është e mundur përditë ose së paku në fillim (pasditës së parë) dhe në përfundim (ditës së fundit) të dekolonizimit.
- Vendosni një peshqir mbi jastëk dhe peshqirin e ndërroni përditë.
- Ndërroni përditë peshqirat e duarve/ lecat e pastrimit (përdorim personal) dhe rrobat e brendshme/ pizhamet.
- Lani teshat në lavatriqe nga 40° - 60°C.

Deodorant/ brusha e dhëmbëve/ syzet

- Përdorni gjatë dekolonizimit një Deo- Spray në vend të një deodoranti Roll-on.
- Vendosni brushën e dhëmbëve me krye në një gotë me tretësin për shpërlarjen e gojës (ndërroni përditë tretësin). Përdorni pas përfundimit të dekolonizimit një brushë të re të dhëmbëve.
- Pastroni brushën/ krahnin/ shnollat e flokëve dhe rrethin e syzeve përditë me „sapunin“ dezinfektues.
- Pastroni aparatën e ndëgjimit sipas të dhënave të prodhuesit.

Produktet, afati kohor i dekolonizimit**Produktet**

- „Sapuni“ dezinfektues: p.sh. Stellisept® med foam, Octenisan®, Hibiscrub®, Lifoscrub®
- Tretësi për pastrimin e gojës: p.sh. Chlorhexamed® forte 0,2% paalkohol, Betadine® koncentrat dezinfektues për shpërlarje
- Kremi i hundës: kremi i hundës Bactroban®

Zgjatja e trajtimit: 5 ditë

Fillimi (data)	Mbarimi (data)	Dushi	Shpërlarja e gojës	Kremi i hundës
		1x në ditë	mëngjës + mbrëmje	mëngjës + mbrëmje

Për pyetje dhe informata drejtoheni mjekut të shtëpisë ose higjienës spitalore në spitalin tuaj.